



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 545/004
Dt 14.04.2017

Në bazë të nenit 48, pika 1.3, të Statutit të Përkohshëm, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 13.4.2017, mori:

VENDIM

- I. Refuzohet si e pabazë ankesa e Petrit Islamit me nr. prot. 23 të datës 12.01.2017, e paraqitur kundër raportit të Komisionit recensues për mospërzgjedhjen e tij, në bazë të konkursit të shpallur më 31.10.2016 të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".
- II. Vërtetohet në tërësi raporti i komisionit recensues i shpallur në buletin nr. 9, në bazë të të cilit është shpallur njoftimi nga UMIB se: "Askush nuk i plotëson kriteret për pozitën një asistent për lëndët: Filozofi e edukimit, Pedagogji e edukimit parashkollor, Metodologji e edukimit gjithëpërfshirës, Strategjitë e edukimit parashkollor, Bazat e hulumtimit në edukim, Teori e mësimi, Edukimi gjithëpërfshirës me metodologji, Praktika pedagogjike", në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".

Arsyetim

Universiteti i Mitrovicës ka shpallur konkurs për zgjedhjen e një asistenti për lëndët: Filozofi e edukimit, Pedagogji e edukimit parashkollor, Metodologji e edukimit gjithëpërfshirës, Strategjitë e edukimit parashkollor, Bazat e hulumtimit në edukim, Teori e mësimi, Edukimi gjithëpërfshirës me metodologji, Praktika pedagogjike, në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".

Pas shpalljes së buletinit nr. 9 në ueb-faqen zyrtare të UMIB-it, ankimesi Petrit Islami ka paraqitur ankesë me nr. prot. 23, të datës 12.01.2017, me të cilin pretendon se i është bërë shkelje nga ana e komisionit recensues për mospërzgjedhjen e tij në këtë pozitë, duke u bazuar në nenin 159, pika 2, sipas të cilit nota mesatare në studimet bachelor dhe master duhet të llogaritet në mënyrë kumulative për të dy nivelet.

Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 13.4.2017, duke pasur parasysh propozimin e Komisionit për ankesa dhe parashtresa, konstatoi se propozimi i Komisionit recensues është në pajtim të plotë me nenin 159, pika 2 të Statutit të UMIB-it ku parashihet që: kandidati për t'u zgjedhur asistent duhet "të ketë notën mesatare në studimet bachelor dhe master jo më pak se 8". Kjo do të thotë se, kandidati për t'u zgjedhur asistent duhet të ketë notën mesatare jo më pak se 8 në secilën prej niveleve të studimit, d.m.th. duhet të ketë notën mesatare jo më pak se 8 në nivelin bachelor dhe jo më pak se 8 në nivelin master.. Në bazë të kësaj që u tha më sipër, Senati vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, MASHT-it.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Të përmendurit;
3. Fakultetit;



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it